

Data: 30.06.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje sistem kirurgjikal per kirurgji te hapur dhe Laparaskopike”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 33192100-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 6,975,000.00 (gjashte milion e nenteqind e shtatedhete e pese mije) leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Spitali Rajonal Lezhe** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Shuma e sigurimit të ofertës është; 139,500.00 (njqind e tridhjetë e nente mije e peseqind) leke...;

Argumentimi:Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (3 viteve fundit nga data e hapjes së ofertave të tenderit), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë 40% të fondit limit që konkuron. Per kete operatori ekonomik duket te dorezoje vertetim leshuar nga Dega e tatim Taksave.2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar.

Vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë : 2,790,000.00 (dy milion e shtateqind e nentdhjete mije) leke pa TVSH .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar: në nenin 43 pika 2/b dhe pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vlera për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, te jetë në vlerë : 2,790,000.00 (dy milion e shtatëqind e nentëdhjetë mijë) leke pa TVSH .

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 4 te neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ne te cilen gjejme te përcaktuar se : pika 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te neni 40 ne te cilen eshte përcaktuar: pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në neni 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ne te cilen eshte përcaktuar: pika 4 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të*

deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për aftësinë e tyre teknike nepermjet përvojave të duhura që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit për zbatimin e kontratës. Për këto është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Ne baze të VKM-se nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 55, pika 4/b ku citohet se: "Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës"

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese (të plotësohet në shtojcën I të DST).

Argumentimi: (Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".ne te cilen eshte percaktuar: Pika 8 " Autoriteti/enti kontraktor ,pervec kerkesave te parashikuara ne kete nen ,mund te percaktoje kriteret e vecanta ne varesi te objektit qe prokurohet ,te cilat i vlereson te nevojshme per ekzekutimin me sukses te kontrates " dhe keto kerkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancojë se furnizimi të mallit objekt prokurimi).

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent, ose ISO 13485 "Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë për pajisjet mjeksore", /ose ekuivalent/, të vlefshme, për prodhuesin/t e artikujve të ofruar ose ofertuesi të paraqes një vetëdeklarim që furnizuesi është konform standardeve të cilësisë, dhe AK të rezervojë të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit si dhe në rastin kur OE shpallet fitues, AK të kërkojë paraqitjen e certifikatës në fjalë

Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Çertifikata të jetë brenda afatit të vlefshmerisë, në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Si dhe ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik"ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, ia kredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose CE ose FDA sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC, të vlefshme, ose ekuivalent, për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar duke u bazuar në piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020"Per Prokurimin Publik", ne te cilen gjejme te percaktuar se:*

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ I vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar I akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Si dhe ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik"ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ I vlerësimit të konformitetit, ia kredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqese autorizim nga kompania prodhuese për tregëtimin e artikujve të ofruar apo nga distributori i autorizuar nga prodhuesi..

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar ne pikat 2 dhe 4 te nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe piken 5 te nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ku eshte e cituar:*

Pika 5. "Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/entikontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojnë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t'u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet nga ana e njësisë së prokurimit si e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas ligjit 89/2014 "Për pajisjet mjekësore".

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", në të cilën gjëme të percaktuar se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Gjithashtu ky kriter është bazuar dhe në nenin 21, 22 dhe 23 të Ligjit Nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore".

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertes dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe në pjeset që kanë lidhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose.

2.3.8 Deklarate per permbushjen e afatit te garancise. (minimumi 2 vjet garanci, perfshirë blerjen dhe zevendesimin e pjeseve te difektuara me pjese kembimi te reja dhe origjinale).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku shprehet rrjedhimisht se Autoriteti Kontraktor mund të hartojë kritere në perpjesetim dhe të lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates, si dhe pika 8 e po ketij neni ne te cilen eshte percaktuar : Pika 8. Autoriteti/enti kontraktor ,pervec kerkesave te parashikuara ne kete nen ,mund te percaktojë kritere te vecanta ne varesi te objektit qe prokurohet ,te cilat i vlereson te nevojshme per ekzekutimin me sukses te kontrates

2.3.9 Duhet te paraqitet vetëdeklaratë:

- Që merr përsipër trajnimin e dy personave (mjekë dhe teknikë) për cdo pajisje.
- Per furnizimin sipas kerkeses se AK, me pajisje te reja, sipas prodhuesit te deklaruar ne oferte.
- Për përmbushjen e afatit të garancisë sipas përcaktimeve në specifikimet teknike të DST
- që merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë artikujve në vendin e dorëzimit.

Argumentimi. Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, ne pikat 5, 6 dhe 8 te nenit 40 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“

Ky kriter eshte kerkuar ne menyre qe AK te sigurohet qe subjekti/shoqeria qe do te kryej furnizimin, te bej trajnimin e stafit mbi menyren e perdorimit te kesaj pajisje mjekesore te cilat do te jene prodhim i viteve te fundit, ku per kete arsye lind nevoja qe perdorimi I kesaj pajisje nga stafi mjekesore duhet domosdoshmerisht trajnimi per perdorimin e tyre ne menyre sa me eficente

2.3.10 Ofertuesi duhet te kete ne stafin e tij te pakten nje inxhinier te trajnuar per servis te pajisjeve mjekesore.

Per kete duhet te paraqese: Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit,

Operatori ekonomik fitues, përpara se të lidhe kontratën me AK duhet te paraqese dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të deklaruara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar duke u bazuar në pikën 4 te nenit 77 te Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se:

1.Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale ,Autoriteti ose enti kontraktor mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomik zoterojne burimet e nevojshme

njerezore e teknike ,si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standarti te pershtatshem cilesie

Si dhe ne piken 5/c te nenit 40 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”ku percaktohet se: Pika 5. Per te provuar pershtatshmerine per te kryer veprimtarie profesionale ,kapacitetet teknike dhe profesionale Autoriteti/enti kontraktor, kerkon:Fuqine punetore te operatorit ekonomik te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit .

Ky kriter eshte kerkuar ne menyre qe AK te sigurohet qe subjekti/shoqeria qe do te kryej furnizimin te kete nje specialist i cili do te kryej instalimin dhe trajnimin e stafit mjeksor duke patur parasysh qe pajisja do te jete e prodhim i viteve te fundit.

Shënim për operatorët ekonomik:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”

Gjithashtu risjellim ne vemendje se:

- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit permbushes per keto pika do te jete kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.

- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1- Sistem kirurgjikal per kirurgji dhe laparoscopi me 5 fole instrumentash

- ✓ Sistemi duhet te kete ekran me ngjyra dhe prekje, me minimum diagonal 10 inch.
- ✓ Pajisja duhet te jete e pajisur me teknologjine WLAN për komunikim me pajisje te tjera qe te mundesojne pershtatjen e te dhenave (Settings) sipas kerkesave specifike te mjekeve, mirmbajtjen e pajisjes dhe perditesimin(Update) me te rajat e sistemit te radhes.
- ✓ Sistemi duhet te jete e pajisur me fole multifunksionale te cilat mund pranojne njekohesisht instrumenta monopolar dhe bipolar, fole per instrumentat e fusionit termik si dhe te bej njohjen automatike te instrumentit te vendosur.
- ✓ Sistemi duhet te kete nje dizajn modular qe te mundesojte instalimin e nen-sistemeve te tjera(Koagulimi me ane te gazit argon, prerjen e ane te presioni te ujit, aspirator per thithjen e tymrave gjate kirurgjise etj) ne te njetin trolley.
- ✓ Sistemi duhet te kete te pakten 4 fole per instrumenta te ndyshem(pa perfshire elektroden neutrale) dhe mundesi rikonfigurimi ne rast nevojje.
- ✓ Sistemi duhet te ofroje mundesine e perzgjedhjes se programeve dhe nen-programeve me ane te pedalit te kembes.
- ✓ Sistemi duhet te jete I pajisur me aftesine per te treguar statusin momental te elektrodes neutrale si dhe funksionin neonatal te saj.
- ✓ Sistemi duhet te kete kapacitet per ruajtjen e programeve dhe aplikacioneve me nje minimum prej 250 programesh.

2- Karroce per vendosjen e sistemit kirurgjikal

I pershtatshem per te montuar systemin kirurgjikal

Permasat 630 x 940 x 650 mm

Pesha 31 kg,

Me 4 rrota qe percojne elektricitetin dhe me frena tek secila

1 hyrje per rrymen elektrike

3 dalje per rrymen elektrike

2 mbajtse per kabujt

Kosh per mbajten e instrumentave

3- Pedal dysh me buton shtese per ndrrimin e programeve

E perbere nga 3 butona, 1 per prerje 1 per koagulim dhe 1 per te nderruar nenprogramet pa patur nevoje te lagohemi nga zona sterile

Te ket mbeshtetese metalike per te mos rreshkitur

Rezistente ndaj ujit ose dezinfektanteve AP & IP X8

Gjatesi kabulli te pakten 5 m

4- Pedal tek me buton shtese per ndrrimin e programeve

E perbere nga 2 butona, 1 per koagulim dhe 1 per te nderruar nenprogramet pa patur nevoje te lagohemi nga zona sterile

Rezistente ndaj ujit ose dezinfektanteve AP & IP X8

Gjatesi kabulli te pakten 5 m

5- Pinca bipolare laparoskopike per termo-fusion

Pinca bipolare laparoskopike per termo-fusion (Instrument shumperdorimsh gjatesia 340mm diameter 5mm, masha Maryland e veshur me material jo ngjites dhe me konektor MF(multifunctional connector.)Me Funksion Auto Stop.

6- Pinca Bipolare per Kirurgji te hapur 210mm dhe kabell 4m

Pinca Bipolare per Kirurgji te hapur 210mm dhe kabell 4m (Instrument shumperdorimsh gjatesia 210mm Nofulla e instrumentit te valezuara e kthyer 25 grade dhe me konektor MF(multifunctional connector.)Me Funksion Auto Stop.

7- Kabell lidhes me elektroden neutral

Kabell lidhes me elektroden neutrale (Gjatesia 4-5 meter).

8- Elektrode neutral

Elektrode neutral(Per sistemin Nesy, Elektrode neutrale pa kabell e ndare dhe me unaze ekuipotenciale per qarkullim te njetrajtshem te rrymes)

9- Aplikator monopolar

Aplikator monopolar(Shumperdorimsh me 2 butona, diameter I brendshem 4mm dhe me kabell 4 meter)

10- Set instrumentash per aplikator monopolar

Set instrumentash per aplikator monopolar(Seti i perbere prej 5 instrumentash elektroda thike 24mm x3.4mm dhe gjatesi 45mm)

Argumentimi per specifikimet teknike : *Keto specifikime jane vendosur ne baze te shkreses me Nr.348 date 29.03.2023“. Argumentim te fondit limit dhe specifikimeve teknike “jane vendosur nga*

nga Komisioni i argumentimit te fondit limit dhe hartimit te specifikimeve teknike ne perputhje me nenin 4 pika 38/b, te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", ne piken 2 te nenit 40 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Sistem kirurgjikal per kirurgji dhe laparoskopji me 5 fole instrumentash	1	Spitali Rajonal Lezhe	40 dite nga data e lidhjes se kontrates
2	Karroce per vendosjen e sistemit kirurgjikal	1	Spitali Rajonal Lezhe	40 dite nga data e lidhjes se kontrates
3	Pedal dysh me buton shtese per ndrrimin e programeve	1	Spitali Rajonal Lezhe	40 dite nga data e lidhjes se kontrates
4	Pedal tek me buton shtese per ndrrimin e programeve	1	Spitali Rajonal Lezhe	40 dite nga data e lidhjes se kontrates
5	Pinca bipolare laparoskopike per termo-fusion	2	Spitali Rajonal Lezhe	40 dite nga data e lidhjes se kontrates
6	Pinca Bipolare per Kirurgji te hapur 210mm dhe kabell 4m	2	Spitali Rajonal Lezhe	40 dite nga data e lidhjes se kontrates
7	Kabell lidhes me elektroden neutrale	2	Spitali Rajonal Lezhe	40 dite nga data e lidhjes se kontrates
8	Elektrode neutral	100	Spitali Rajonal Lezhe	40 dite nga data e lidhjes se kontrates
9	Aplikator monopolar	2	Spitali Rajonal Lezhe	40 dite nga data e lidhjes se kontrates
10	Set instrumentash per aplikator monopolar	10	Spitali Rajonal Lezhe	40 dite nga data e lidhjes se kontrates

Afatet e levrimet : Njësia referuar relacionit të përlogaritjes së fondit limit përcaktoi kohëzgjatjen si më poshtë :

Afati i kontrates eshte: 40 (njetete) dite nga data e lidhjes se saj.

Sasia dhe Grafiku I levrimet : jane vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 40 te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilen gjejme te percaktuar se: 1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.

Në lidhje me *kushtet e veçanta për kualifikim*, njësia bazuar në rregullat e prokurimit publik të referueshme, në raport me shumën dhe shërbimin e kërkuar përcaktoi këto kritere si minimumin e kërkuar për t'u plotësuar nga operatorët ekonomikë.

Njesia e prokurimit, referuar nenit 49 pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 përcaktoi afatet e dorëzimit dhe hapjes të ofertave si me poshtë :

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje apo hapjen e tyre :
13.07.2023 ora 09:00.

NJËSIA E PROKURIMIT

Lule Zeneli

Edison Pjetraj

Rajmonda Huba